

Giuseppina Turano

Università Ca' Foscari Venezia – Italia

Tipare sintaksore të fjalive lokative dhe ekzistenciale

Në këtë punim, do të analizojmë strukturën sintaksore të fjalive lokative dhe të fjalive ekzistenciale të gjuhës shqipe. Deri më sot, këto nuk janë trajtuar as në kuadrin e gjuhësisë tradicionale, as në atë të gjuhësisë moderne. Pra, ky punim synon të vërë në dukje tiparet themelore që i karakterizojnë, duke përdorur një kuadër teorik që bazohet në koncepte gjenerative. Strukturat e shqipes do t'i krahasojmë me ato gjegjëse të disa gjuhëve të tjera evropiane, si rusishtja, italishtja, anglishtja, frëngjishtja, për të vënë në dukje dukuritë e përbashkëta ashtu si edhe dallimet midis tyre.

Fjalët kyçe: fjali lokative, fjali ekzistenciale, parafjalë, temë, sintaksë

1. Hyrje

Në këtë punim, do të analizojmë dy lloje fjalish: lokativet dhe ekzistencialet. Me fjali lokative kuptojmë atë tip fjalie që tregon se cili është vendi ku ndodhet diçka: për shembull 'librat' në (1). Me fjali ekzistenciale kuptojmë atë tip fjalie që i referohet ekzistencës ose pranisë së diçkaje: për shembull 'libra' në (2):

(1) librat janë mbi bankë

(2) mbi bankë ka libra

Fjalitë lokative dhe ekzistenciale të gjuhës shqipe nuk kanë qenë kurrë objekt i studimeve specifike, as në kontekstin e gramatikës tradicionale, as me metodat e gjuhësisë moderne. Këtu do të ndalemi në strukturën sintaksore të këtyre fjalive, për të vënë në dukje tiparet themelore që i karakterizojnë. Strukturat e shqipes do t'i krahasojmë me ato gjegjëse të disa gjuhëve të tjera evropiane, me të cilat shqipja ka disa pika të përbashkëta ashtu si edhe disa dallime.

Në kuadrin e gjuhësisë moderne, këto dy lloje fjalish kanë tërhequr vëmendjen e studiuesve duke u nisur nga vitet '90 të shekullit njëzet. Ndër të parët citojmë studiuesin Ray Freeze (1992), i cili, duke analizuar gjuhë të familjeve të ndryshme gjuhësore, ka propozuar një teori të unifikuar të fjalive lokative dhe të fjalive ekzistenciale e bazuar në një strukturë sintaksore të vetme në të cilën argumentet tematike janë dy: Lokativi, që realizohet si sintagmë parafjalore (*mbi bankë*), dhe Tema, që realizohet si sintagmë emërore (*librat/libra*). Pra, në themel të të dy konstrukteve, kemi një strukturë sintaksore të vetme. Interpretimet e ndryshme, lokativ vs ekzistencial, vijnë nga rendi relativ i dy argumenteve, siç e shpjegon autori, duke përdorur shembuj nga gjuha ruse, në të cilën fjalitë lokative dhe ato ekzistenciale kanë të njëjtat argumente me të njëjtën formë morfologjike, por me vend të ndryshëm: me temën (*kniga* 'libër') që i paraprin lokativit (*na stole* 'mbi bankë'), fjalia është lokative, si në shembullin (3):

(3) *Kniga byla na stole* (Freeze 1992)
 'Një libër/libri ishte mbi bankë'

Me rendin e përmbytur, ku lokativi (*na stole*) i paraprin temës (*kniga*), fjalia është e identifikuar si fjali ekzistenciale, si në shembullin (4):

(4) *Na stole byla kniga* (Freeze 1992)
 mbi bankë ishte libër/libri
 'Mbi bankë kishte një libër'

Ndryshimi i kuptimit lidhet ngusht me rendin e argumenteve. Ky konstatim është në bazë të mendimit të Freez-it se lokativet dhe ekzistencialet thjesht paraqesin renditje të ndryshme të të njëjtëve përbërës.

Duke u nisur prej kësaj ngjashmërie strukturore, Freez-i (1992) ka hipotetizuar një strukturë sintaksore të vetme në themel të të dy konstrukteve. Sipas Freez-it, në fakt, struktura bazë e këtyre konstrukteve është e njëjtë, ndërsa struktura sipërfaqësore është rezultat i mënyrës se si të dy përbërësit vendosen brenda çdo strukture të vetme. Kështu, kur gjejmë një lokativ në pozicionin e subjektit, struktura bëhet ekzistenciale, ndërsa kur në pozicionin e subjektit gjejmë temën, struktura bëhet lokative. Pra, ajo që i bën këto fjali të dallojnë nga njëra-tjetra është se njëri prej dy argumenteve zhvendoset drejt fillimit të fjalisë, në pozicionin e kryefjalës.

Përveç kësaj veçorie, një tjetër tipar i përbashkët, në gjuhët që shfaqin këtë alternim të vendit ku gjenden tema dhe lokativi, është një efekt shquarsie që ka të bëjë me temën: nëse tema është një sintagmë emërore e shquar, kjo duhet të qëndrojë në fillim të fjalisë, ku luan rolin e kryefjalës. Nëse tema

është një sintagmë emërore e pashquar, duhet të qëndrojë në fund të fjalisë; në këtë rast, kryefjala e strukturës është përbërësi lokativ që gjendet në fillim të fjalisë.

Kështu, sipas Freez-it ka një marrëdhënie shumë të ngushtë midis zhvendosjes së temës dhe shquarsisë së saj. Thënë ndryshe, është pikërisht kategoria e shquarsisë që e bën të domosdoshme lëvizjen e temës në fillim të fjalisë.

Në gjuhën ruse, efekti i shquarsisë nuk dallohet mirë sepse sintagma emërore *kniga* ‘libër’, që shfaqet në strukturat lokative dhe ekzistenciale, mbetet morfologjikisht e pandryshuar, kështu që nuk është e qartë nëse ajo është një formë emërore e shquar ose e pashquar. Kuptimi i saj varet nga konteksti, prandaj është e pamundur ta testojmë këtu.

Ndërvarësia mes lëvizjes së temës dhe kategorisë së shquarsisë mund të testohet në gjuhë të tjera, si italishtja, për shembull, që i ngjan gjuhës ruse sepse interpretimi i fjalive, edhe në këtë gjuhë, varet nga rendi i të dy argumenteve. Pra, në shembullin (5), ku tema është në fillim të fjalisë, kemi një fjali lokative:

- (5) *Il libro è sul tavolo*
‘Libri është mbi bankë’

kurse në shembullin (6), ku në fillim të fjalisë kemi sintagmën lokative, fjalia është ekzistenciale¹:

- (6) *Sul tavolo c'è un libro*
mbi bankë Ø është një libër
‘Mbi bankë ka një libër’

Siç shihet, kuptimet e ndryshme të këtyre fjalive rrjedhin nga pozicioni i dy argumenteve, ashtu siç e ka argumentuar Freez-i, për gjuhët e tjera. Pra, italishtja përdor të njëjtën teknikë të gjuhës ruse. Por, ndryshe nga rusishtja, italishtja shënon qartë kategorinë e shquarsisë/pashquarsisë, nëpërmjet nyjave shquese dhe joshquese/zero. Dallimi morfologjik midis sintagmave emërore të shquara dhe sintagmave emërore të pashquara bëhet me anë të nyjave shquese *il/lo/la/i/gli/le* (këta janë baraz me treguesit emëror të shquarsisë -i,-u, -a, -ja,

¹ Në italisht, në të vërtet, kemi një situatë pak të ndryshme në krahasim me rusishten: në fjalinë ekzistenciale, është i domosdoshëm përdorimi i klitikut lokativ *ci*:

- (i) *Sul tavolo c'è un libro*
mbi bankë Ø është një libër
‘Mbi bankë ka një libër’
(ii) **Sul tavolo è un libro*

-t, -të, që, në gjuhën shqipe, u prapavendosen emrave), nyjave joshqese *un/uno/una* ('një') ose nyjes zero.

Efekti i shquarsisë, që Freez-i, e konsideron, së bashku me lëvizjen e argumenteve, si faktor për ndryshimin e kuptimit nga lokativ në ekzistencial, del qartë në italisht, ku tema në fillim të fjalisë duhet të jetë e shquar, ndërsa kur mbetet në fund të fjalisë, duhet të jetë e pashquar. Ky korrelacion del në pah duke krahasuar fjalitë gramatikore në (7a) dhe (8a) me ato jogramatikore në (7b) dhe (8b):

- (7) a. ***Il libro** è sul tavolo*
'Libri është mbi bankë'
b. ****Un libro** è sul tavolo*
një libër është mbi bankë

- (8) a. *Sul tavolo c'è **un libro***
mbi bankë është një libër
'Mbi bankë ka një libër'
b. **Sul tavolo c'è **il libro***
mbi bankë është libri

Kështu, shembujt e italishtes tregojnë se, kur fjalia ka një sintagmë emërore të shquar, kjo duhet të shkojë lart, në pozicionin e subjektit. Kur ka një sintagmë emërore të pashquar, kjo duhet të mbetet brenda sintagmës foljore, duke i lënë sintagmës lokative pozicionin e subjektit.

Sipas Freez-it, këto janë dy tiparet që dallojnë fjalitë lokative nga ato ekzistenciale: ndryshimi i vendit të argumenteve dhe trajta e shquar ose e pashquar e temës. Gjuha ruse dhe ajo italiane i përshtaten kësaj teorie, edhe pse këto dy gjuhë nuk janë të lidhura gjenetikisht.

Pak gjuhë në botë, sipas Freez-it, nuk shfaqin ndryshimin e rendit të dy argumenteve. Ndër gjuhët evropiane, një shembull është ai i gjuhës angleze, e cila ka temën (*book* 'libër') gjithmonë përpara lokativit (*on the table* 'mbi bankë'), si në fjalinë lokative (9) ashtu dhe në fjalinë ekzistenciale (10):

- (9) *The book is on the table*
'Libri është mbi bankë'

- (10) *There is a book on the table*
Ø është një libër mbi bankë
'Mbi bankë ka një libër'

Në këtë pikë, anglishtja sillet ndryshe nga rusishtja dhe italishtja. I vetmi element që ndryshon vend, në shembujt e mësipërm, është folja *is* ‘është’, që shfaqet një herë pas (9) dhe një herë përpara temës (10). Pra, anglishtja ka një model që dallon nga gjuhët e tjera sepse nuk ka alternim midis temës dhe lokativit dhe nuk përdor ndryshimin e vendit të argumenteve si faktor për ndryshimin e kuptimit të fjalive. Megjithatë, anglishtja bashkëndon me gjuhët e tjera tiparin e shquarsisë, por ky tipar nuk lidhet dot me zhvendosjen e temës, që, siç e pamë, nuk lëviz në fillim të fjalisë. Shquarsia e temës luan gjithsesi rol të rëndësishëm për të dalluar fjalinë lokative prej asaj ekzistenciale. Pra, fjalia lokative ka temë të shquar (11a) dhe nuk pranon temë të pashquar (11b):

- (11) a. *The book is on the table*
 ‘Libri është mbi bankë’
 b. **A book is on the table*
 një libër është mbi bankë

Ndërsa, fjalia ekzistenciale kërkon temë të pashquar (12a) dhe nuk pranon temë të shquar (12b):

- (12) a. *There is a book on the table*
 ‘Mbi bankë ka një libër’
 b. **There is the book on the table*
 është libri mbi bankë

Dy tipare të tjera, që Freez-i nuk i vë në dukje, por që i bashkëndajnë, pak o shumë, të gjitha gjuhët që autori ka analizuar janë: a) përdorimi i foljes *JAM* dhe b) përshtatja e foljes *JAM* me temën.

Italishtja është një prej atyre gjuhëve që i shfaq të dyja këto tipare: në gjuhën italiane, fjalitë lokative dhe fjalitë ekzistenciale ndërtohen me foljen *ESSERE* ‘Jam’. Folja përshtatet gjithmonë me temën, siç mund ta vërejmë në shembujt (13), ku folja *è* është në vetën e tretë njëjës, si tema *il libro/un libro* ‘libri/ një libër’:

- (13) a. *Il libro è sul tavolo*
 ‘Libri është mbi bankë’
 b. *Sul tavolo c’è un libro*
 mbi bankë Ø është një libër
 ‘Mbi bankë ka një libër’

Edhe kur tema është në shumës, si *i libri/dei libri* ‘librat/disa libra’, kjo përshtatet me foljen në vetën e tretë shumës *sono* ‘janë’:

- (14) a. *I libri sono sul tavolo*
 ‘Librat janë mbi bankë’
 b. *Sul tavolo ci sono dei libri*
 mbi bankë Ø janë disa libra
 ‘Mbi bankë ka disa libra’

Fjalitë lokative dhe ekzistenciale ku folja nuk përshtatet me temën janë jogramatikore, si në shembujt (15) dhe (16):

- (15) a. **Il libro sono sul tavolo*
 libri janë mbi bankë’
 b. **Sul tavolo ci sono un libro*
 mbi bankë Ø janë një libër
- (16) a. **I libri è sul tavolo*
 librat është mbi bankë
 b. **Sul tavolo c'è dei libri*
 mbi bankë Ø është disa libra

Edhe në gjuhën angleze, këto dy lloje fjalësh ndërtohen me foljen *BE* ‘Jam’, e cila përshtatet me temën, si në fjalitë lokative:

- (17) a. *The book is on the table*
 ‘Libri është mbi bankë’
 b. *The books are on the table*
 ‘Librat janë mbi bankë’

ashtu si në fjalitë ekzistenciale:

- (18) a. *There is a book on the table*
 ‘Mbi bankë ka një libër’
 b. *There are books on the table*
 ‘Mbi bankë ka libra’

Midis gjuhëve evropiane, gjendet një gjuhë tjetër, me një model të ndryshëm: frëngjishtja. Në këtë gjuhë, si në anglisht, të dy argumentet, tema dhe lokativi, nuk ndryshojnë vend: tema gjithmonë i paraprin lokativit në fjalinë lokative (19), ashtu si në fjalinë ekzistenciale (20):

- (19) *Le livre est sur la table*
 ‘Libri është mbi bankë’

- (20) *Il y a un livre sur la table*
Ø Ø ka një libër mbi bankë
'Mbi bankë ka një libër'

Por, ndryshe nga anglishtja dhe nga gjuhë të tjera, në frëngjisht, këto dy lloj fjalish nuk ndërtohen të dyja me foljen *ÊTRE* 'Jam'. Kjo shfaqet vetëm në fjalitë lokative (19), ndërsa fjalitë ekzistenciale kërkojnë foljen *AVOIR* 'Kam' (20).

Frëngjishtja ka një veçori tjetër: tema përshtatet me foljen vetëm në fjalitë lokative, ku folja është *ÊTRE* 'Jam', si në shembullin (21), ku tema njëjës përshtatet me foljen në vetën e tretë njëjës:

- (21) *Le livre est sur la table*
'Libri është mbi bankë'

dhe në shembullin (22), ku tema, në shumës, përshtatet me foljen në vetën e tretë shumës:

- (22) *Les livres sont sur la table*
'Librat janë mbi bankë'

Në fjalitë ekzistenciale, ku folja është *AVOIR* 'Kam', kemi një kryefjalë si *il*, që nuk ka përmbajtje semantike, por përdoret vetëm për të mbushur vendin e kryefjalës, sepse frëngjishtja nuk e pranon që vendi i kryefjalës të mbetet i pashprehur. Kur fjalia është ekzistenciale, folja *AVOIR* 'Kam' nuk përshtatet me temën, por vetëm me subjektin *il*, siç e tregojnë shembujt (23):

- (23) a. *Il y a un livre sur la table*
Ø Ø ka një libër mbi bankë
'Mbi bankë ka një libër'
b. *Il y a des livres sur la table*
Ø Ø ka disa libra mbi bankë
'Mbi bankë ka disa libra'
c. **Il y ont des livres sur la table*
Ø Ø kanë disa libra mbi bankë

Frëngjishtja bashkëndan me gjuhët e tjera vetëm efektin e shquarsisë së temës: kërkon një sintagmë emërore të shquar në fjalitë lokative dhe një sintagmë emërore të pashquar në fjalitë ekzistenciale:

- (24) a. *Le livre est sur la table*
 ‘Libri është mbi bankë’
 b. **Un livre est sur la table*
 një libër është mbi bankë
- (25) a. *Il y a des livres sur la table*
 ka disa libra mbi bankë
 b. **Il y a les livres sur la table*
 ka librat mbi bankë

Nga kjo paraqitje, sado e shkurtër, bie në sy fakti se ka disa dallime midis gjuhëve. Edhe kur strukturat sintaksore të gjuhëve duket se ngjajnë, shfaqen veçori tipike për çdo gjuhë. Rusishtja, për shembull, nuk dallon morfologjikisht shquarsinë/pashquarsinë e temës. Italishtja përdor një klitik lokativ në fjalitë ekzistenciale. Anglishtja nuk përdor ndryshimin e vendit të argumenteve për të transformuar fjalitë lokative në fjali ekzistenciale. Frëngjishtja, ashtu si anglishtja, nuk ndryshon rendin e argumenteve por dallon fjalitë përmes foljeve *ÊTRE* ‘Jam’ dhe *AVOIR* ‘Kam’. Megjithatë, ka një pikë në të cilën këto gjuhë bashkohen: tema, në fjalitë lokative, duhet të jetë e shquar ndërsa, në fjalitë ekzistenciale, duhet të jetë e pashquar.

Pas kësaj hyrjeje, në të cilën kemi paraqitur të dhënat e disa gjuhëve evropiane, dhe, duke pasur parasysh këtë linjë hulumtimi, do të ndalemi tani në disa veçori dhe karakteristika të fjalive lokative dhe ekzistenciale të gjuhës shqipe.

2. Të dhënat e shqipes

Siç e përmendëm më sipër, nuk ka, deri më sot, studime të veçanta kushtuar fjalive lokative dhe ekzistenciale të gjuhës shqipe. Ato nuk janë trajtuar as në kuadrin e gjuhësisë tradicionale, as në atë të gjuhësisë moderne. Në këtë seksion, do të shqyrtojmë strukturën morfo-sintaksore të këtyre fjalive për të vënë në dukje tiparet themelore që i karakterizojnë.

Siç do ta shohim, shqipja ka një model të përzier, që në disa trajta u përafrohet të dhënave të rusishtes dhe të italishtes, ndërsa, në disa trajta të tjera u përafrohet të dhënave të frëngjishtes. Pra, në disa pika u jep mbështetje supozimeve të Freez-it, ndërsa në disa pika të tjera, hipotezat e këtij autori nuk mund t’i zbatohen gjuhës shqipe.

Prej shembujve të sjellë në (1) dhe (2), që po risjellim në (26), del se edhe në këtë gjuhë, argumentet sintaksore të fjalive lokative dhe ekzistenciale janë dy: tema, e shprehur me anë të një sintagme emërore (‘librat’/‘libra’) dhe lokativi, i shprehur me anë të një sintagme parafjalore (‘mbi bankë’):

- (26) a. Librat janë mbi bankë
b. Mbi bankë ka libra

Variante të këtyre fjalive mund të ndërtohen edhe me parafjalën ‘në’, siç mund të shihet në (27):

- (27) a. Nxënësit janë në klasë
b. Në klasë ka nxënës

Ajo që bie menjëherë në sy është se, edhe në shqip, rendi i argumenteve ndryshon interpretimin e fjalive. Në qoftë se tema (‘librat’/‘nxënësit’) i paraprin lokativit (‘mbi bankë’/‘në klasë’), si në shembujt (26a) dhe (27a), atëherë fjalia është lokative. Me rendin e përmbysur, si në shembujt (26b) dhe (27b), fjalia është ekzistenciale. Strukturat ekzistenciale pa përmbysjen e dy argumenteve nuk janë gramatikore (28), duke dëshmuar se rendi i argumenteve lidhet me kuptimin e fjalive dhe se lëvizja e sintagmës lokative në fillim të fjalisë është e domosdoshme (29):

- (28) a. *Ka libra mbi bankë
b. *Ka nxënës në klasë

- (29) a. Mbi bankë ka libra
b. Në klasë ka nxënës

Kështu, edhe shqipja e provon teorinë e Freez-it se lokativet dhe ekzistencialet paraqesin renditje të ndryshme të të njëjtëve përbërës. Organizimi i argumenteve brenda fjalisë është i njëjtë me atë të rusishtes dhe të italishtes.

Edhe pse teoria e Freez-it duket e përshtatshme për gjuhën shqipe, siç e thamë më lart, përfundimi i autorit nuk mund t’i zbatohet tërësisht shqipes sepse në shqip, rendi i ndryshëm i dy përbërësve nuk është i mjaftueshëm për të dalluar këto dy struktura. Siç shihet në (26) dhe (27), krahas ndryshimit të rendit të argumenteve, shqipja ka një veçori tjetër: fjalia lokative kërkon foljen ndihmëse *JAM*, ndërsa ajo ekzistenciale kërkon foljen ndihmëse *KAM*. Pra, fjalia lokative (30a) është gramatikore vetëm me foljen *JAM*: kjo nuk mund të zëvendësohet nga folja *KAM*, që është e papranueshme (30b):

- (30) a. Librat janë mbi bankë
b. *Librat/libra kanë/ka mbi bankë

Përkundrazi, fjalia ekzistenciale është gramatikore me foljen *KAM* (31a), ndërsa përdorimi i foljes *JAM* sjell agramatikalitet (31b):

- (31) a. Mbi bankë ka libra
b. *Mbi bankë janë libra/librat

Pra, përzgjedhja e foljes ndihmëse ka rol diferencues. Këtu shqipja ka një lloj ngjashmërie me frëngjishten, e cila përdor foljen *ÊTRE* ('Jam') në fjalitë lokative dhe foljen *AVOIR* ('Kam') në fjalitë ekzistenciale. Por kjo ngjashmëri nuk është e plotë sepse strukturat lokative dhe ekzistenciale të gjuhës shqipe largohen nga ato të frëngjishtes në dy pika. E para është se në gjuhën franceze, tema *le livre* i paraprin gjithmonë sintagmës lokative *sur la table*, veçori kjo që e hasim edhe në anglisht, e cila megjithatë dallon nga frëngjishtja sepse nuk shfaq alternim të foljeve ndihmëse. Pika e dytë është se në frëngjisht, folja *AVOIR* ('Kam'), e domosdoshme në fjalitë ekzistenciale, përshtatet me subjektin espletiv *il*, siç e tregojnë shembujt (23), kurse, në gjuhën shqipe, folja *KAM* nuk përshtatet me asnjë argument. Kështu, në shembullin (32b), kemi foljen 'ka', në formën e tretë njëjës, që nuk përshtatet me temën 'libra', që është në shumës. Megjithatë fjalia është gramatikore. Përkundrazi, në shembullin (32c), kemi foljen 'kanë' në shumës si tema 'libra', por fjalia është jogramatikore:

- (32) a. Mbi bankë ka një libër
b. Mbi bankë ka libra
c. *Mbi bankë kanë libra

Pra, të dhënat e gjuhës shqipe, ku folja *KAM* nuk përshtatet me asnjë argument brenda fjalisë, nuk përputhen as me ato të frëngjishtes.

Të gjitha këto veçanti e bëjnë shqipen të ketë disa dallime në krahasim me gjuhën ruse, italiane, angleze, franceze. Të vetmin tipar të përbashkët që bashkëndan shqipja me gjuhët e mësipërme është trajta e shquarsisë/pashquarsisë së temës, që në gjuhën shqipe del qartë si në italisht, frëngjisht, anglisht. Kështu, kur tema gjendet në fillim të fjalisë, në pozicionin e kryefjalës, kemi një sintagmë emërore të shquar, siç shihet nga kundërvënja midis fjalisë gramatikore dhe asaj jogramatikore në shembujt (33):


- (33) a. Librat janë mbi bankë
b. *Libra janë mbi bankë

ndërsa, kur në fillim të fjalisë gjendet përbërësi lokativ 'mbi bankë', tema, në fund të fjalisë, duhet të jetë e pashquar:

- (34) a. Mbi bankë ka libra
 b. *Mbi bankë ka librin/librat

Thënë shkurt, emrat në trajtën e pashquar nuk mund të shfaqen në fjalitë lokative, ndërsa emrat në trajtën e shquar nuk mund të shfaqen në fjalitë ekzistenciale. Nga vjen ky kufizim? Si përftohet kuptimi i shquarsisë/pashquarsisë së emrave?

Në kuadrin e gramatikës gjenerative, shumë studiues janë marrë me strukturën e brendshme të sintagmës emërore dhe me kategorinë e determinantit që përkon me vetitë referenciale të emrit. Abney (1987), i pari, propozon t'i shtohet projeksonit maksimal NP (*Noun Phrase*) projekcioni DP (*Determiner Phrase*). Sipas autorit, D është pozicioni ku shfaqen vetitë e shquarsisë së emrit, si trajta e shquar, nyja e përparme 'një', përemrat dëftorë si 'ky'/'ai' e kuantifikatorët si 'disa', 'shumë', 'pak', etj. Kategoria D fikson referencialitetin e emrit. Pra, emri del si komplement i determinantit D që projekton një sintagmë determinante DP:



Në këtë skemë, koka D merr si komplement projeksonin maksimal të emrit (NP). Në pozicionin kokë N është gjeneruar emri ndërsa në pozicionin kokë të sintagmës determinante D gjenerohet determinanti. D është pozicioni ku gjenerohet edhe trajta e shquar e emrit që bashkohet me emrin kur ky zhvendoset në pozicionin D për t'u trupëzuar me nyjen. Pra, nga forma, emrat mund të jenë DP (kur shoqërohen nga një element i tipit D) ose NP (kur emri shfaqet pa elemente të kategorisë D).

Nga pikëpamja semantike, dallimi midis emrave të shquar e të pashquar bazohet në vetitë referenciale. Stockwell (1973), ashtu si edhe të tjerë, dallon tri klasa emrash:

- (36) 1. Emra të shquar
 2. Emra të pashquar me interpretim specifik
 3. Emra të pashquar me interpretim jospesifik

Në gjuhën shqipe, janë emra të shquar emrat e përveçëm si ‘Benin’ në (37a), emrat në trajtën e shquar si ‘djalin’ në (37b), emrat e shoqëruar nga përemrat dëftorë si ‘atë djalë’ në (37c).

- (37) a. Mjeku vizitoi Benin
- b. Mjeku vizitoi djalin
- c. Mjeku vizitoi atë djalë

Të tria sintagmat në (37) janë projeksione maksimale DP.

Janë emra të pashquar me interpretim specifik emrat e shoqëruar nga nyja e përparme si ‘një makinë’ në (38):

- (38) Beni bleu një makinë

Edhe ky është një projeksion maksimal DP.

Janë emra të pashquar me interpretim jospecifik emrat në formën bazike, pa elemente të kategorisë D, si ‘makinë’ në (39):

- (39) Beni bleu makinë

Ndryshe nga të tjerët, emri ‘makinë’ në (39) nuk është projeksion maksimal DP, por projeksion maksimal NP.

Pra, interpretimi specifik-jospecifik i emrave varet nga prania ose mungesa e elementeve të kategorisë D.

Duke pasur në fokus këto fakte, kthehemi tek fjalitë lokative dhe ekzistenciale. Siç e pamë më sipër, një prej kufizimeve që i karakterizon është se fjalitë lokative kërkon temë të shquar, kurse ajo ekzistenciale kërkon temë të pashquar. Ky dallim lidhet ngusht me funksionin gramatikor të temës: në fjalinë lokative, tema kryen funksionin e kryefjalës siç e dëshmon fakti se shfaqet në rasën emërore:

- (40) a. Libri është mbi bankë/Librat janë mbi bankë
- b. *Librin/librit është mbi bankë/*Librave/librash janë mbi bankë

ndërsa, në fjalinë ekzistenciale, tema kryen funksionin e kundrinorit, siç e dëshmon nyja ‘të’ e mbiemrit në shembullin (41a):

- (41) a. Mbi bankë ka një libër të ri/një çantë të re
- b. *Mbi bankë ka një libër i ri/një çantë e re

Ky fakt ka rëndësi të veçantë sepse, siç e shpjegon Longobardi (1992), vetëm sintagmat DP, jo sintagmat NP, mund të kryejnë funksionin e kryefjalës. Kjo vlen për të gjitha foljet, pavarësisht nga fakti nëse janë kalimtare (42) ose jokalimtare (43):

- (42) a. Studenti lexon librin/Studentët lexojnë librat
- b. Një/ai student lexon librin/Disa/ata studentë lexojnë librat
- c. *Student lexon librin/*Studentë lexojnë librat

- (43) a. Studenti fle/Studentët flenë
- b. Një/ai student fle/Disa/ata studentë flenë
- c. *Student fle/*Studentë flenë

Pra, janë gramatikore fjalitë (42a-b) dhe (43a-b) që kanë për kryefjalë një sintagmë DP, ndërsa jogramatikor janë shembujt (42c) dhe (43c), ku emri del në trajtën e pashquar, në formën bazike, i pashoqëruar nga elemente të kategorisë D. Në (42c) dhe (43c), emri projekton vetëm kokën N të një sintagme NP.

Veçori e ndërtimeve lokative, në të gjitha gjuhët që kemi marrë në konsideratë në këtë punim, është se tema, në pozicionin e kryefjalës, shprehet me anë të një emri, jo vetëm të shquar, por edhe specifik. Pra, ky kufizim lidhet, nga njëra anë me faktin se kryefjala duhet të jetë një DP referenciale (Longobardi 1992), dhe nga ana tjetër me karakteristikat semantike të lokativit.

Për sa i përket temës, në fjalitë ekzistenciale, kjo, siç e kemi parë në (41), kryen funksionin e objektit. Kundrinorët, ndryshe nga kryefjalët, mund të shprehen me anë të sintagmave DP ose NP:

- (44) a. Beni bleu makinën/Beni bleu makinat
- b. Beni bleu atë/një makinë/Beni bleu ata/disa makina
- c. Beni bleu makinë/Beni bleu makina

Ndryshe nga ndërtimet (42c) dhe (43c), që janë jogramatikore, ato në (44c) janë gramatikore, duke dëshmuar se kur emri luan rolin e kundrinës mund të shprehet me anë të një forme bazike si ‘makinë’/‘makina’.

Duke u kthyer tek ekzistencialet, tema, që luan rolin e kundrinës, mund të shprehet me anë të një emri të pashquar në formën bazikë si ‘libra’ (45a), me anë të një emri të shoqëruar nga nyja e përparme (45a) ose me anë të kuantifikatorëve (45b). Emrat e shquar (45c), ashku siç i klasifikojnë Stockwell-i etj. (1973), nuk lejohen sepse semantika e ekzistencialit kërkon një emër të pashquar me interpretim specifik ose jospecifik.


- (45) a. Mbi bankë ka libra/ka një libër
 b. Mbi bankë ka shumë/pak/disa libra
 c. *Mbi bankë ka librin/këtë libër/atë libër

Nga kjo skicë krahasuese e disa gjuhëve evropiane, pa lidhje të ngushta gjenetike midis tyre, del se modeli i formimit të fjalive lokative dhe ekzistenciale të gjuhës shqipe, edhe pse ka ngjashmëri me atë të gjuhëve të tjera, nuk përputhet plotësisht me asnjërin prej tyre: strukturat e analizuar nuk janë plotësisht simetrike. Pra mund të dalim në përfundimin se shqipja ka veçoritë e veta, që e dallojnë nga ato të gjuhëve të tjera.


3. Analiza

Pas kësaj paraqitjeje të shkurtër, le të saktësojmë strukturën e brendshme të fjalive lokative dhe ekzistenciale.


Sipas Freez-it (1992) këto janë të derivuara nga një strukturë bazë ku të dy elementet, tema dhe lokativi, gjenerohen brenda një sintagme parafjalore PP (*Prepositional Phrase*), përkatësisht në pozicionin e specifikuesit (tema) dhe në pozicionin e komplementit (lokativi):



Nga kjo strukturë bazë, Freez-i gjeneron fjalinë lokative me anë të lëvizjes së temës në pozicionin SpecIP (specifikuesi i *Inflectional Phrase*). Pema sintaksore në (47) ilustron derivimin e fjalisë lokative me të dhënat e rusishtes: tema *kniga* ('libri'), që në fjalitë lokative shërben si kryefjalë, lëviz në pozicionin SpecIP ku i caktohet rasia emërore nga folja *byla* ('ishte'), që realizohet në pozicionin e kokës I (*Inflection*), ku gjenerohen dhe kontrollohen trajtat e kohës dhe të vetës:



Ndryshe nga fjalitë lokative, që gjenerohen me zhvendosjen e temës, në fjalitë ekzistenciale, sipas Freez-it, është sintagma lokative *na stole* ('mbi bankë') që lëviz në ballë të fjalisë, në pozicionin e specifikuesit të sintagmës IP, duke dhënë rendin linear lokativ-temë:



Tema *kniga* ('libri'), që në këtë rast është kundrinë, mbetet në pozicion e saj fillestar.

Një analizë e tillë, sipas Freez-it, arrin të derivojë si ndërtimet lokative ashtu dhe ndërtimet ekzistenciale.


Edhe pse struktura e propozuar nga Freez-i derivon në mënyrë të thjeshtë të dhënat e gjuhës ruse, ajo nuk merr parasysh faktin se, në disa gjuhë, për të gjeneruar fjalitë ekzistenciale, veç lëvizjes së sintagmës lokative në ballë të fjalisë, është e domosdoshme folja *KAM* në vend të foljes *JAM*, që shfaqet në fjalitë lokative. Pra, lëvizja e argumenteve jo gjithmonë mjafton për t'i derivuar të dyja fjalitë.

Në gramatikën gjenerative, shumë studiues janë marrë me studimin e foljeve ndihmëse *KAM* dhe *JAM* (Freeze 1992, Kayne 1993, Den Dikken 1997). Duke u bazuar në idenë e Benvenist-it (1966), i cili thotë se folja latine *HABEO* 'Kam' është e kundërta e *MIHI EST* 'më është', këta studiues kanë analizuar foljen *KAM* si rezultat i përfshirjes së një parafjale në foljen *JAM*, dmth se *KAM* mund të rishkruhet si: *JAM + P*.

Gjuha frënge, në fakt, ka alternimin midis *AVOIR* (49a) dhe *ÊTRE + P* (49b):

- (49) a. *Marie a le livre*
 ‘Maria ka librin’
 b. *Le livre est à Marie*
 libri është tek Maria
 ‘Maria ka librin’


Sipas këtij koncepti, struktura për të derivuar foljen *KAM* ka një pozicion PP, koka e të cilit është një parafjalë e porealizuar fonetikisht (P). Kjo parafjalë lëviz në pozicionin I, ku trupëzohet me foljen *JAM*. Rezultati i këtij inkorporimi shqiptohet *KAM*:



Konkluzioni është se folja *KAM* del si rezultat i inkorporimit të një parafjale në foljen *JAM*.


Edhe Freez-i e përdor këtë analizë për derivimin e foljes *KAM*. Pra, për të analizuar fjalitë me foljen *KAM* duhet marrë parasysh edhe ky derivim.

Duke u rikthyer te fjalitë lokative dhe ekzistenciale, shtrohet pyetja nëse teoria e Freez-it mund t’i aplikohet apo jo gjuhës shqipe. Le të fillojmë nga fjalitë lokative. Po të përdorim analizën e autorit, fjalia lokative derivohet si në (51):



Tema dhe lokativi gjenerohen brenda një sintagme PP. Tema, për të marrë rasën emërore, lëviz në pozicionin e specifikuesit SpecIP. Si kryefjalë, në këtë pozicion, përshtatet me foljen e realizuar në pozicionin I. Pra, struktura e Freez-it mund t'i aplikohet shqipes për derivimin e fjalive lokative.


Por, ajo është problematike për fjalitë ekzistenciale, të cilat ndërtohen me foljen *KAM*, dhe kjo paraqet një problem për analizën e Freez-it. Le të shohim pse. Struktura e hipotetizuar nga Freez-i parashikon zhvendosjen e nyjes së ndërmjetme P', që përmban parafjalën dhe komplementin e saj, në pozicionin SpecIP. Kjo lëvizje gjeneron rendin linear Lokativ + Temë. Asgjë tjetër nuk ndodh në gjuhën ruse. Mirëpo, gjuha shqipe ka foljen *KAM* në vend të foljes *JAM*. Rregulla që ndryshon *JAM* në *KAM* është inkorporimi i një parafjale të pashprehur në foljen *JAM*, poshtë nyjës I. Duke shikuar gjuhën shqipe, shohim se fjalia ekzistenciale nuk ka parafjalë të pashprehur që mund të inkorporohet në foljen *JAM*: ajo ka vetëm parafjalën lokative 'mbi' që lëviz bashkë me komplementin e saj 'bankë' në SpecIP. Po të pranohet këtë derivim, fjalia shqipe do të kishte foljen *JAM* në vend të foljes *KAM*:




Shkurt, mungon parafjala që, duke u inkorporuar në foljen *JAM*, derivon foljen *KAM*, të domosdoshme për fjalitë ekzistenciale të gjuhës shqipe. Pra, hipoteza e Freez-it nuk mund të pranohet.

Harley (2002) propozon një strukturë si ajo e Freez-it, në të cilën tema dhe lokativi gjenerohen në pozicionin e specifikuesit dhe të komplementit të një koke P, por ndryshe nga Freez-i, Harley dallon dy lloj parafjalësh: P_{LOC}, që ka përmbajtje semantike, dhe P_{HAVE}, pa përmbajtje semantike. E para, as mund të fshihet, as mund të inkorporohet në elemente të tjera. E dyta, mund të inkorporohet në foljen *JAM* për të derivuar *KAM*. Pra, sipas Harle-it, *KAM* gjenerohet nga inkorporimi i një parafjale të tipit P_{HAVE} (pa përmbajtje semantike) në foljen *JAM*.

Sipas Harle-it, fjalitë lokative gjenerohen me një parafjalë të tipit P_{LOC}, si në skemën në vijim:




Po t'ia aplikojmë gjuhës shqipe, fjalia lokative analizohet në këtë mënyrë:



Tema dhe lokativi gjenerohen brenda sintagmës PP, koka e së cilës është parafjala lokative ‘mbi’. Pastaj, tema, për të marrë rasën emërore, lëviz në pozicionin e specifikuesit SpecIP, duke dhënë rendin linear Temë + Lokativ.

Çfarë ndodh në fjalitë ekzistenciale? Edhe këto kanë dy argumente: temën ‘libra’ dhe sintagmën lokative ‘mbi bankë’. Parafjala e sintagmës lokative është e tipit P_{LOC} që, sikurse u tha më sipër, nuk mund të inkorporohet. Ndryshe nga fjalitë lokative, këto ndërtohen me foljen *KAM*, që, sipas Harle-it, gjenerohet nga inkorporimi i një parafjale të tipit P_{HAVE} në foljen *JAM*. Pra, këto fjali kërkojnë dy parafjalë: një e tipit P_{LOC} , ku gjenerohet elementi ‘mbi’ dhe një tjetër e tipit P_{HAVE} që shërben për të derivuar *KAM*. Fazat e derivimit janë si në vijim:



Sintagma parafjalore ‘mbi bankë’ lëviz në pozicionin e specifikuesit SpecIP. Tema ‘libra’ mбетet brenda sintagmës PP ku i caktohet rasa kallëzore nga koka v. Parafjala P_{HAVE} inkorporohet në foljen JAM për të derivuar foljen KAM.

Si përfundim, mund të themi se teoria e Freez-it, sipas të cilit, në themel të fjalive lokative dhe të fjalive ekzistenciale ka një strukturë sintaksore të vetme mbi të cilën vepron ndryshimi i rendit relativ të të dy argumenteve, nuk mund t’i aplikohet shqipes sepse kjo nuk i përfshin plotësisht të gjitha të dhënat e kësaj gjuhe. Harley, ndryshe nga Freez-i, mbështet tezën e kundërt, sipas së cilës struktura bazë e këtyre fjalive nuk mund të jetë e njëjtë. Të dhënat e shqipes vërtetojnë mendimin e Harle-it se kuptimi i këtyre fjalive nuk është vetëm rezultati i organizimit të argumenteve brenda së njëjtës strukturë, por që, struktura bazë e fjalive lokative dhe ajo e fjalive ekzistenciale është e ndryshme.

Bibliografia

- Abney, S. (1987). The English Noun Phrase in its Sentential Aspect. MIT, Ph.D. dissertation.
- Benveniste, E. (1966). *Problèmes de Linguistique Général*. Paris: Gallimard.
- Den Dikken, M. (1997). The syntax of possession and the verb “have”. *Lingua* 101: 129-150.
- Freeze, R. (1992). Existentials and Other Locatives. *Language* 68/3: 553-595.
- Harley, H. (2002). Possession and the double object construction. *Yearbook of Linguistic Variation* 2: 29-68.
- Kayne, R. (1993). Toward a Modular Theory of Auxiliary Selection. *Studia Linguistica* 47: 3-31.
- Longobardi, G. (1992). Proper Names and the Theory of N-Movement in Syntax and Logical Form, Ms. Università di Venezia.
- Stockwell, R. P., Schachter, P. and B. H. Partee (1973). *The Major Syntactic Structures of English*. New York: Holt, Rinehart and Winston.

Syntactic features of locative and existential sentences

Summary

In this paper, I will analyse the internal structure of Albanian existential and locative constructions. Moving from data coming from a large number of languages of different language families, Freeze (1992) proposes a unified theory of both these constructions based on a single underlying structure in which the thematic arguments are Location and Theme. The different interpretations, locative vs existential, come from the relative order of the two arguments. If the theme precedes the predicate locative, the sentence is locative. With the inverted order, the sentence is identified as an existential. As we will see, Freeze's analysis cannot be fully extended to Albanian, since in Albanian, the difference between existentials and locatives correlates not only with the relative order of the two constituents but it also correlates with the use of two different copular forms: Locatives require the BE-copula whereas existentials require the HAVE-copula. Thus, the different order of the two constituents is not sufficient to distinguish the two structures.

A syntactic derivation which distinguishes between two different types of prepositions, along the lines of Harley (2002), proves to be superior to that proposed by Freeze (1992) which does not capture Albanian data.